

Prishtinë 04/10/2006
Kodi i ZRRE-së: D_16_2006

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Nenit 15 të Ligjit nr. 2004/9 “mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Nenit 35.2 të Ligjit nr. 2004/10 “mbi Energjinë Elektrike”;
3. Dispozitat e Nenit 22.6 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
4. Propozimet e skicimit të faturës të paraqitur nga Zyra e Çështjeve të Rregullatorit në KEK SH.A., tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”), më 14 shtator 2006;
5. Takimet me Divizionin e Furnizimit të KEK-ut që ka përgatitur skicimin e faturës;
6. Komentet ndaj propozimeve të dhëna nga ZRRE-ja më 15 shtator 2006;
7. Faturën e riskuar duke përfshirë komentet e ZRRE-së të paraqitura në KEK më 29 shtator 2006

Më 04 tetor 2006 ka vendosur të nxjerrë:

VENDIMIN E PËRKOHSHËM MBI APROVIMIN E FATURËS SË KEK-UT/DIVIZIONIT TË FURNIZIMIT

Kapitulli 1

1. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar skicën e faturës së paraqitur nga KEK dhe ka vendosur ta aprovojë me disa kushte:
 - a) KEK-u do t’i sigurojë ZRRE-së informacione të qarta mbi informimin/fushatën publike për konsumatorët që do të ndërmerret për të shpjeguar faturën e re;
 - b) Brenda 60 ditësh prej lëshimit të këtij Vendimi, KEK-u do t’i japë ZRRE-së informacione mbi numrin e ankesave të marra prej konsumatorëve rreth skicës së faturës së re;
 - c) KEK-u do t’i sigurojë ZRRE-së reagimin e përgjithshëm të grupeve të ndryshme të konsumatorëve mbi faturën e re;
2. Në rast se konsumatorët nuk janë të kënaqur, ose nuk e kuptojnë faturën, Bordi i ZRRE-së mund t’i kërkojë KEK-ut të bëjë rifreskimin e të dhënave dhe të ndryshojë faturën.
3. KEK-u do të fillojë të zbatojë këtë Vendim prej datës së marrjes së këtij vendimi, dhe publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

4. Ky vendim do të botohet nga KEK-u në faqen e tij elektronike zyrtare dhe të paktën në një gazetë ditore lokale që ka qarkullim të gjerë nëpër Kosovë, pesë (5) ditë pune pas datës së hyrjes në fuqi të tij.
5. **KEK-u ka të drejtën të paraqesë një apel ndaj ZRRE-së kundër këtij Vendimi** duke paraqitur një raport të plotë të qëndrueshëm, brenda katërbëdhjetë (14) ditësh pune pas njoftimit dhe publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim dhe Shtojcat e këtij Vendimi, i janë dorëzuar KEK-ut në versionin original në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare.

Shtojca

Kapitulli 2: Fatura e skicuar e paraqitur në ZRRE nga KEK-u

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Anëtarët e Bordit:
